



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTIRREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr.121, Datë 17.07.2020

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK LUNDRUES MBI REZERVUARIN E HEC BANJA ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW”.

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma ‘a’ të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, , neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe nenit 10, pika 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/6 prot datë 13.07.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC Banjë, me kapacitet të instaluar 2 MW,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 102, datë 24.06.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e Hec Banja me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., është një subjekt përfaqësues në cilësinë e mbajtësit të miratimit, i cili ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën nr. 6077 Rep, nr. 1657 Kol, datë 19.12.2019, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC Banjës, Bashkia Cërrik, me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me miratimin përfundimtar nr. 4657/2 Prot, datë 31.05.2019, ka miratuar ndërtimin e Centralit fotovoltaik lundrues dhe veprave të tij ndihmëse mbi rezervuarin e HEC Banjës, Bashkia Cërrik, Qarku Elbasan nga Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., me kapacitet te instaluar 2 MW.
- Me shkresën nr. 62/17, datë 26.06.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, (data 09.07.2020), nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 754/1 prot, datë 26.06.2020, ERE i'u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 753/2 Prot, datë 07.07.2020, ka përcjellë dokumentacionin e konstatuar në mungesë.
- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të “Rregullores për Procedurat e Licencimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licencave”.
- Nga analiza që i'u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, rezultojnë i plotësuar tërësisht:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.5 gërma “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.4.4 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni leje nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.4.5 gërmat “a” dhe “b”, është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - ERE në zbatim të nenit 38 të Ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.
 - Nga studimi i fizibilitetit të hartuar për Centralin fotovoltaik lundruar të Shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. rezultojnë se jetëgjatësia e një paneli nuk shkon më tepër se 25 – vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të licencojë shoqërinë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Lundruar mbi rezervuarin e HEC Banjë me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25 – vjeçar.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarreveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI IERE

Petrit AHMETI